

Puna me prindërit.

QEZHHEF-ve nxit dhe mbështet bashkëpunimin midis prindërve dhe institucionit të çerdhes duke dhënë informacionin ditor nga ana e kujdestareve dhe përgjegjëseve, duke organizuar klasa prindërimi dhe programe të veçanta nga ana e stafit psiko-social për fëmijët dhe familjet që përjetojnë apo kanë përjetuar më parë divorcin.



Prindërit që janë në proces divorci apo të divorcuar, duhet të njoftojnë kujdestarët e fëmijëve në çerdhe për ndryshimet e reja në jetën e fëmijës, sepse në këtë mënyrë, institucionet do të marrin masa të ndihmojnë fëmijët të ripërtërihen emocionalisht, do të jenë më të vëmendshëm ndaj nevojave për shkak të gjendjes emocionale, do të ofrojnë një kujdes më të madh të shërbimeve psiko-sociale, etj,

Prindërit nuk duhet të rezervohen asnjëherë të kërkojnë informacion apo ndihmë tek specialistët e sektorit psiko-social të QEZHHEF-ve, në mënyrë që fëmijët të ndihmohen sa më shpejt e më mirë për t'u ripërshtatur dhe ripërtërirë emocionalisht gjatë dhe pas divorcit të prindërve të tyre.



**Qendra Ekonomike e
Zhvillimit dhe Edukimit të
Fëmijëve**

**Material konsultues me
prindërit për shqetësimet
e fëmijëve si pasojë e
divorcit të prindërve të
tyre.**

**Adresa: Rruga e Barrikadave.
Nr.tel. 042222991**




Në pjesën më të madhe të rasteve, janë fëmijët ata që e vuajnë të parët divorcin. Në pjesën dërrmuese të rasteve, ata nuk janë asnjëherë dakord me prindërit mbi divorcin, përveçse në rastet kur ata janë të pranishëm, kur njëri nga prindërit dhunohet rëndë apo edhe kur vetë fëmijët janë sistematikisht viktimë të dhunës së prindërve.

Zakonisht gjatë procesit të divorcit, fëmijët trishtohen, vuajnë dhe shfaqin sjellje agresive, ndonjëherë të dhunshme ndaj prindërve, veçanërisht ndaj prindit që e kërkon divorcin. Pas divorcit, edhe ata e vuajnë shkëputjen nga prindi që largohet nga familja, dhe kjo është gjithashtu një periudhë e trishtë dhe delikate në jetën e tyre.

Për këtë arsye nevojitet që prindërit që shkojnë drejt divorcit, të informohen mbi pasojat gjatë dhe pas divorcit për të lehtësuar vuajtjet dhe trishtimin e fëmijëve dhe rritur aftësinë e tyre ripërtëritëse.

Teyber pohon se *“Miti, gjerësisht i shpërndarë, se jetët e fëmijëve janë të shkatërruara njëherë e përgjithmonë prej divorcit është i pavërtetë”*. Ai shpjegon se prindërit mund të bëjnë shumë për të ndihmuar fëmijët e tyre që kalojnë nëpër kriza për shkak të ndarjes/divorcit dhe sugjerojnë se, prindërit

- *duhet të eliminojnë vrazhdësinë e momentit,*
- *të eliminojnë disiplinën joefektive,*
- *të parandalojnë humbjen e kontaktit me prindin tjetër,*
- *të mos ushtrojnë presion tek fëmijët që të mbajnë anën e njërit prind kundrejt tjetrit,*
- *si dhe, të shmangin futjen e fëmijës në rolin e një të rrituri për të përmbushur nevojat e prindërve të tij .*



Prindërit duhet të jenë të duruar.

Shpeshherë, fëmijët do të shfaqin agresivitet në shtëpi dhe në ambientet e tjera ku ata kalojnë ditën, si çerdhja apo kopshti, e ndonjëherë do të shfaqin edhe më shumë agresivitet në ambientet jashtë shtëpisë, sepse në shtëpi do të duan të tregohen të mirë, nga frika se, edhe prindi tjetër mund të largohet.

Prindërit duhet t’iu shpjegojnë fëmijëve se nuk është faji i fëmijëve

dhe se ndonjëherë, mes të rriturve, ndodhin edhe zemërimet, por të dy prindërit e duan dhe do ta duan gjithmonë fëmijën (fëmijët) e tyre. Kjo do të krijojë siguri tek fëmija dhe do të ndihmojë në uljen e zemërimit, stresit apo ankthit, që janë simptoma të zakonshme gjatë përjetimit të kësaj gjendjeje tek fëmijët.

Prindërit nuk duhet të rreshtin së komunikuar me fëmijët e tyre gjatë

kësaj faze tranzitive dhe t’iu përgjigjen atyre më gjuhë të thjeshtë e sa më të kuptueshme për moshën e tyre.